

# SIGURIA E PAJISJEVE TË MBROJTJES PERSONALE

Informacion për operatorët ekonomikë

Kjo broshurë jep informacion mbi përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë në lidhje me pajisjet e mbrojtjes personale për të garantuar sigurinë e jetës dhe shëndetit të përdoruesve, si dhe lëvizjen e lirë në treg të këtyre pajisjeve.



## Pse duhet garantuar siguria?

Pajisjet e sigurisë, të njohura gjithashtu si pajisje mbrojtëse personale, janë krijuar posaçërisht për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet shëndetësore ose të sigurisë në vendin e punës. Përdorimi i tyre është veçanërisht i rëndësishëm në industrinë e prodhimit dhe minerat, për shkak të rrezikshmërisë së lartë që paraqesin këto mjedise. Në Shqipëri, mesatarisht çdo muaj 10-15 punëtorë raportojnë dëmtime serioze si pasojë e aksidenteve në punë, ndërsa 2 punëtorë në muaj humbin jetën si pasojë e këtyre aksidenteve. Rreth 18% e rasteve të raportuara i përkatën sektorit minierar dhe 66% të rasteve u përkatën aksidenteve në vendin e punës në sektorët si ndërmarrje prodhuese, ndërtim dhe të tjera. Përdorimi i pajisjeve të duhura të mbrojtjes personale nga punëtorët ul numrin e aksidenteve të parandalueshme që ndodhin në vendet e punës çdo vit.

## Ku mund të merret informacion për parashikimet ligjore?

Garantimi i sigurisë për pajisjet e mbrojtjes personale bazohet në rregullin teknik "Për pajisjet e mbrojtjes personale" i miratuar me VKM-në nr. 674/2021, nga ligji nr.10 489/2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore" dhe ligji nr.10 480/2011 "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore" i ndryshuar. Ato përcaktojnë rregullat për vendosjen në tregun shqiptar të këtyre pajisjeve. Këto akte ligjore si dhe informacione të tjera mbi sigurinë e produkteve mund të gjenden në faqen zyrtare të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (www.ishmt.gov.al).

## Cilat konsiderohen Pajisje Mbrojtëse Personale (PMP)?

Çdo pajisje e projektuar dhe e prodhuar për t'u veshur ose për t'u mbajtur nga një person për mbrojtje nga një ose më shumë rreziqe; Komponentët e këmbësorëve të tyre, të cilat janë thelbësore për funksionet mbrojtëse; Sistemet lidhëse për këto pajisje, që nuk mbahen ose vishen nga një person, por janë projektuar të lidhin atë pajisje me një mjet të jashtëm apo pikë të qëndrueshme mbështetjeje (ankorim).

Përjashtohen këtu PMP-të e projektuara dhe të prodhuara për përdorim nga Forcat e Armatosura ose të ruajtjes së rendit, për përdorim privat për kundërtë kundërve atmosferike jekshtreme apo lagështisë dhe ujit gjatë lartës së enëve, për mbrojtjen e kokës, fytyrës dhe syve të përdoruesve të motokikletave dhe tricikleve, etj. (shiko rregullin teknik për listën e plotë).

## Si garantohet përputhshmëria e pajisjeve mbrojtëse personale me kërkesat thelbësore të sigurisë?

### ✓ Markimi CE

- Markimi CE i konformitetit vendoset nga prodhuesi apo organi i vlerësimit të konformitetit, sipas rastit, para se PMP-ja të vendoset në treg, për të vërtetuar se ajo është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë;
- Markimi CE i konformitetit fiksoshet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paqeshme në PMP, ose kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së PMP-së, në paketim ose në dokumentet shoqëruese;
- Markimi CE dhe, në rastet e parashikuara, numri i identifikimit të organit të vlerësimit të konformitetit, shoqërohen nga një piktoigram apo shenja të tjera që tregojnë rrezikun ndaj të cilit të mbrohet PMP-ja;
- Kur PMP-ja është shumë e vogël për të mundësuar fiksimin e të gjithë ose një pjesë të markimit të nevojshëm, informacioni përkatës duhet të jepet në paketim dhe në udhëzimet e prodhuesit;
- Ndalohej vendosja mbi PMP-në i çdo markimi që mund të mashtrijet palë të treta si në kuptimin ashtu dhe në formën e markimit CE;
- Markimi CE i konformitetit përbehet nga inicialet CE në formën e mposhtesha, duke respektuar përmasat e vizatimit të shkallëzuar:



## Çfarë është Deklarata EU e konformitetit?

Çdo PMP që vendoset në treg, duhet të shoqërohet nga Deklarata EU e konformitetit. Ky dokument shërben për të vërtetuar se pajisja është në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë dhe lëshohet nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit, sipas një formati të përcaktuar.

### Deklarata EU e konformitetit duhet të përmbajë këto elemente:

- PMP (numri i produktit, tipit, grupit apo serisë);
- emri dhe adresa e prodhuesit dhe, sipas rastit, përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- objektet i deklarates (identifikimi i PMP-së që mundëson gjurmueshmërinë e saj);
- sipas rastit, të dhënat mbi llojin (modulin) e procedurës së vlerësimit të konformitetit, si edhe për organizimin evropian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri e të miratuar, të përfshirë në procedurë;
- referencat për standardet e harmonizuara të përdorura;
- datën, vendin dhe nënshkrimin.

\*Deklarata EU e konformitetit përketet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të kërkuar nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

### ✓ Detyrimet e operatorëve ekonomikë

#### • Prodhuesi – Projektimi dhe prodhimi në përputhje me kërkesat ligjore

- Siguron që PMP-ja është projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë;
- Siguron hartimin e dokumentacionit teknik dhe kryen ose kërkon kryerjen e procedurës së vlerësimit të konformitetit;
- Harton deklaratën EU të konformitetit dhe vendos/fiksion markimin CE të konformitetit;
- Mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EU të konformitetit për 10 vjet, pasi ka vendosur PMP-në në treg;
- Siguron që zbatohen procedurat me qëllim që prodhimi në seri të mbetet në konformitet me kërkesat e rregullit teknik;
- Siguron se PMP-ja që ka vendosur në treg mban një numër tipi, grupi apo serie ose elemente të tjera identifikuese ose, kur madhësia apo natyra e PMP-ve nuk e lejon, informacioni jepet në paketimin ose në dokumentet shoqëruese;
- Vendos në PMP emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare;
- Siguron që PMP-ja të shoqërohet nga udhëzimet për përdorim nën gjuhën shqipe;
- Udhëzimet, informacionet, si edhe etiketimet, duhet të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të lexueshme.

#### • Importuesi – Vendosja në treg vetëm e PMP-ve konform kërkesave ligjore

- Sigurohet që prodhuesi ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit dhe ka hartuar dokumentacionin teknik;
- Sigurohet që PMP-ja ka markimin CE dhe shoqërohet me dokumentet e kërkuara dhe udhëzimet për përdorim nën gjuhën shqipe;
- Sigurohet që prodhuesi ka vendosur në PMP: elementet e identifikimit të saj (numër tipi, grupi apo serie), emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar, si edhe adresën e tij postare;
- Vendos në PMP emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare ku mund të kontaktohet;
- Siguron që gjatë kohës që PMP-ja është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e produktit me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë;
- Mban deklaratën e konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për 10 vjet pas vendosjes së PMP-së në treg.

#### • Shpërndarësi - Kujdesi i duhur për kërkesat e zbatueshme ndaj PMP-ve

- Verifikon që PMP-ja mban markimin CE të konformitetit dhe produkti është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar dhe udhëzimet e informacionin në gjuhën shqipe, lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesi i fundit;
- Verifikon nëse prodhuesi ka përmësuar detyrimet për vendosjen në PMP të elementeve për identifikimin e saj, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar, adresën postare;
- Siguron që kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e PMP-së me kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë.

## Identifikimi i operatorëve ekonomikë

Operatorët ekonomikë sipas kërkesës duhet të identifikojnë: Çdo operator ekonomik i cili ka furnizuar ata me PMP; Çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me PMP.

### KUJDES!

Importuesi dhe shpërndarësi konsiderohen si prodhues kur ai vendos PMP në treg nën emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar, ose modifikon PMP-të e vendosura në treg në mënyrë të tillë që të preket përputhshmëria me kërkesat e parashikuara nga rregulli teknik.

### Prezumimi i konformitetit të PMP

PMP që janë në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, konsiderohen në përputhje me kërkesat thelbësore të sigurisë të përcaktuara në rregullin teknik.

### Kërkesa të sigurisë:

PMP-të duhet të ofrojnë mbrojtje të përshtatshme nga risqet ndaj të cilave synojë të mbrojnë; PMP-të duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që, në kushtet e parashikueshme të përdorimit të synuar, përdoruesi të mund të kryejë aktivitetin e lidhur me riskun në mënyrë normale ndërsa gëzon mbrojtjen e duhur të nivelit më të lartë të mundshëm; PMP-të duhet të projektohen dhe të prodhohen në mënyrë që të mos krijnë risqe ose faktorë të tjerë shqetësues në kushtet e parashikueshme të përdorimit; Përshatja e PMP-ve me morfologjinë e përdoruesit; Lehtësia dhe fuqia e PMP-ve duhet të jenë sa më të lehta që të jetë e mundur, pa ndikuar te forca dhe efektiviteti i tyre; Përveç emrit dhe adresës së prodhuesit, udhëzimet që duhet të jepen me PMP-të duhet të përmbajnë të gjitha informacionet përkatëse për udhëzimet për ruajtjen, përdorimin, pastrimin, mirëmbajtjen, kujdesin dhe dezinfektimin.



Implemented by



Publikim i mundësuar nga projekti "Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit në Kapitujt Ekonomikë të Acquis" (SANECA) financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim dhe zbatuar nga GIZ Shqipëri.

Përmbajtja e kësaj broshure ka karakter informues. Detyrime ligjore të plota jepen në aktet ligjore të përmendura në brendësi të broshurës.

